



**VLERËSIMI I  
ATRAKTIVITETIT  
TERRITORIAL  
NË EVROPËN JUGLINDORE**

*Rezultatet e Projektit  
Attract -SEE*

---

# 1. PARATHËNIE

Bashkëpunimi transnacional në kuadër të projektit Attract-SEE për vlerësimin e atraktivitetit territoriale në Evropën Juglindore (EJL) gjendet në fazën e fundit të aktiviteteve të vitit 2014. Organizatat e ndryshme partnere dhe vëzhguese kanë punuar intensivisht në dy tema kryesore - krijimin e një sistemi të përbashkët të monitorimit territorial, dhe përmirësimin e procesit të koordinimit të politikave. Mund të them se gjatë aktiviteteve dyvjeçare, projekti Attract-SEE ka ofruar një shumëllojshmëri të ngjarjeve dhe aktiviteteve interesante, ka mundësuar një shkëmbim të gjerë të njohurive dhe shqyrtim të temave të ndryshme në fushën e monitorimit të territorit.

Në lidhje me zhvillimin e një sistemi të përbashkët të monitorimit të territorit, ne jemi përqendruar në nevojat e politikbërësve dhe vendimmarrësve në Evropën Juglindore. Pasi projekti është bazuar në nevojat reale të shprehura nga politikbërësit dhe vendimmarrësit, kemi zhvilluar mjete dhe qasje që do të t'u ndihmojnë të rrisin cilësinë e vendimeve të zhvillimit. Kemi zbatuar rezultate konkrete, siç janë zhvillimi i një kornize të përbashkët territoriale të monitorimit dhe planeve të veprimit për krijimin e sistemeve të monitorimit të territorit në rajonet e përfshira. Kemi hartuar raporte trans-nacionale, nacionale dhe rajonale të cilësisë dhe atraktivitetit territorial. Secili partner i projektit ka përgatitur nga një Raport Nacional të Atraktivitetit Territorial (tetë raporte) duke përdorur një metodologji të përbashkët, dhe në bazë të këtyre raporteve kemi prodhuar një raport sintezë për vendet / rajonet partnere (Raporti Trans-Nacional i Atraktivitetit të Territorit). Këto raporte konsiderohen si "raporte zero" për sistemet e ardhshme kompatible të monitorimit që mbulojnë rajonin.

Organizimi i punëtorive trans-nacionale dhe punëtorive për përfshirjen e palëve të interesuara nga ana e partnerëve tanë në vendet e EJL-së kanë çuar në krijimin apo forcimin e rrjeteve të përhershme të palëve të interesuara dhe përmirësimin e koordinimit të politikave të ndryshme të zhvillimore dhe sektoriale. Të gjithë partnerët bien dakord se kemi arritur nivelin e përmirësimit të procesit të koordinimit të politikave që do të çojë në një numër më të madh të vendimeve cilësore të bazuara mbi njohuritë territoriale, pra zbatimin më efikas të qëllimeve të kohezionit territorial.

Attract-SEE ka organizuar dhe ka marrë pjesë në disa ngjarje ku kemi paraqitur rezultatet dhe arritjet tona.

Gjatë zbatimit të projektit krahas arritjes së rezultateve të planifikuara dhe objektivave të projektit, kemi punuar edhe mbi idetë për projekte të reja në të ardhmen. Rezultatet tona të përbashkëta do të përdoren si një platformë për bashkëpunim të ri transnacional.

Ju urojmë lexim të këndshëm,

Blaz Barborič,  
në emër të partnerit kryesor,  
Instituti Gjeodezik i Sllovenisë.

---

## 2. ARSYET E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT ATTRACT-SEE

### 2.1. PROBLEMET E IDENTIFIKUARA NË RAJONIN E EJL-SË

Në të gjitha vendet e EJL-së bëhet gjithnjë e më e qartë se arritja dhe realizimi i qëllimeve të kohezionit territorial është kërcënohen nga koordinimi i dobët në mesin e politikëbërësve në sektorë të ndryshëm dhe në nivele të ndryshme të administratës. Qëllimet e përcaktuara në politikat e BE-së dhe strategjitë trans-nacionale mund të përmbushen vetëm duke përdorur planifikimin e zhvillimit të integruar dhe të bazuar në dëshmi dhe zbatimin në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Në fushën e monitorimit territorial, shumë aktivitete dhe projekte të ndryshme tashmë janë iniciuar dhe janë zbatuar. Ekziston shumë praktikë e mirë, por në nivelet kombëtare dhe rajonale në vendet e Evropës Juglindore **ka ende një mungesë të njohurive, metodologjive të harmonizuara, dhe mjeteve efikase për monitorimin e gjendjes aktuale dhe trendit të zhvillimit territorial.** Ekziston gjithashtu një mungesë e zgjidhjeve normative për themelimin e kornizës/sistemit të monitorimit të AT-së – mungesë e mjedisit të volitshëm ligjor. Kjo rezulton me një kuptim të kufizuar të zhvillimit territorial në mesin e politikëbërësve, dhe mungesë e vetëdijes se si politikat sektoriale mund të ndikojnë territorin si një tërësi.

Për të minimizuar ndikimet e padëshiruara zhvillimore në territoret e Evropës Juglindore, nevojitet një poqes politik i bazuar në fakte, duke përfshirë monitorimin e statusit dhe tendencave aktuale. Që të arrihen qëllimet e caktuara të kohezionit territorial, duhet të përfshihen politikëbërësit dhe vendimmarrësit sektorial në procesin e monitorimit si pjesëmarrës aktiv dhe si një grup qëllimor që ka nevojë për mbështetje për të kuptuar efektet konkrete territoriale të politikave të tyre.

Proceset e efektshme zhvillimore mbështeten në njohuritë e duhura në lidhje me territoret në bazë të përgjigjeve të përditësuara dhe të gatshme

për ta përdorur në pyetjet përkatëse për tendencat aktuale dhe nxitësit e ndryshimit territorial. **Projekti Attract-SEE ka adresuar këto probleme specifike:**

- **mungesa e metodologjive/instrumenteve të përbashkëta** në mesin e planifikuesve të zhvillimit territorial për analizën e gjendjes dhe tendencave në territoret e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një kontekst transnacional dhe rezulton me një mungesë të të dhënave të harmonizuara territorial dhe të mjeteve të monitorimit për të mbështetur vendimet e politikëbërësve

- **Mungesa e të kuptuarit dhe njohurisë së përbashkët të tendencave aktuale në territorin** dhe mbi dimensionin territorial të politikave të zhvillimit në mesin e politikbërësve të ndryshëm dhe nivele të ndryshme të administratës.

- **Mungesa e njohurive dhe aftësive të zhvillimit territorial** te ekspertët për ndjekjen e tendencave territoriale, që rezulton me një ndjekje të papërshtatshme të tendencave territoriale të politikbërësit dhe nëpunësit të administratës

- **mungesa e konsiderimit të dimensionit territorial** gjatë hartimit të politikave dhe zbatimin e tyre nga politikbërësit dhe vendimmarrësit.

- **mungesa e koordinimit mes politikbërësve sektorial dhe niveleve të ndryshme të administratës** në zhvillimin dhe zbatimin e politikave.

---

## **2.2. QASJE DREJT SOLUCIONIT**

Qëllimi i projektit të Attract -SEE ishte të krijojë një kuadër të monitorimit territorial dhe koordinimit të politikave, si dhe mjetet me të cilat politikbërësit dhe vendimmarrësit mund të rrisin cilësinë e vendimeve të tyre të zhvillimit. Duke marrë parasysh afatin e kufizuar të këtij projekti, qëllimi i projektit është ngushtuar në "cilësinë dhe atraktivitetin e territorit" si fushë tematike e përbashkët, relevante, ndër-sektoriale. Atraktiviteti territorial ishte zgjedhur si një temë që shkon më larg se problemet lokale dhe interesat e ngushtë sektorial, që kërkojnë shtrirjen më të gjerë territoriale dhe zgjidhje apo veprime të përbashkëta.

**Janë marrë këto hapa:**

- identifikimi i zhvillimit të **përbashkët** territorial dhe **problemet/sfidat** që kanë të bëjnë me proceset politike brenda zonës transnacionale në EJK;

- Krijimi i një **kuadri hapësinor të harmonizuar të monitorimit** të bazuar në prova të aplikueshëm në rajonin më të gjerë të Evropës Juglindore, me të cilin është e mundur të konstatohet dhe të kuptohet statusi dhe tendencat e nxitësve të ndryshimit territorial;

- vlerësimi i statusit të territorit dhe **identifikimi i tendencave** me theks të veçantë në cilësinë dhe atraktivitetin e territorit;

- ndërgjegjësimi i **politikbërësve/vendimmarrësve** mbi rëndësinë e koordinimit dhe trajtimit të dimensionit të territorit në hartimin dhe zbatimin e politikave;

- rritja e **njohurive dhe aftësive** të ekspertëve të zhvillimit territorial për t'ua përcjellë informacionet mbi statusin dhe tendencat territoriale në mënyrë më efektive politikbërësve/vendimmarrësve për të arritur integrim më të mirë të politikave;

- Krijimi i një kuadri për procesin e koordinimit të politikës në çdo vend që do të mbështetet nga rrjetëzimi i **politikbërësve/vendimmarrësve** përkatës;

- Koordinimi i procesit të hartimit/zbatimit të politikave në fushën tematike të cilësisë dhe atraktivitetit territorial.

Një tjetër objektiv ishte identifikimi i sfidave të përbashkëta dhe problemeve në fushën trans-nacionale dhe vëzhgimin e tyre me treguesit uniform. Për të mbështetur monitorimin me tregues, u përgatit një bazë e përbashkët të dhënash, në mënyrë që të lejojë ndryshime dhe përmirësime varësisht nga nevojat konkrete të territoreve të veçanta.

**Një supozim themelor i projektit ishte që zgjidhjet e veçanta (shembuj të praktikës së mirë) janë tashmë zhvilluara, të zbatuara dhe janë në dispozicion për shkëmbimin midis vendeve të ndryshme të EJK-së dhe partnerëve në projekt.**

### **Projekti u zbatua me anë të aktiviteteve të mëposhtme:**

- **identifikimi i nevojave** të vendimmarrësve në procesin e zhvillimit të territorit. Krijues të politikave dhe vendimmarrës të ndryshëm u angazhuan në procesin e hartimit të monitorimit territorial, sigurimin e informacioneve të nevojshme, dhe mënyrën e paraqitjes të këtyre informacioneve. Këto UP përdorën gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit për hartimin e kornizës së monitorimit të territorit. U vendos një proces i koordinimit u vendos në nivel nacional/rajonale. U hartua një doracak për koordinimin e procesit dhe bëheshin përmirësime të vazhdueshme që rridhnin nga përvoja e mbledhur gjatë projektit.

- **analiza e kornizave ekzistuese të monitorimit territorial** (KMT) në vendet partnere që çojnë drejt një regjistri të praktikave të identifikuar ekzistuese, që shërben si një bazë të dhënash të ekspertizës për hartimin e KMT-ve.

- **Zhvillimi i një modeli të përbashkët teorik** të KMT-së, që përcakton procesin e përgjithshëm të monitorimit të territorit, duke filluar me nevojat e vendimmarrësve, mbledhjes dhe analizës së të dhënave, përgatitjes dhe të llogaritjes të treguesve, duke përmbyllur me përgatitjen e një raporti territorial..

- **zbatimi i një modeli teorik**, në vendet/rajonet partnere mbi temën ndërsektoriale dhe shumë nivelëshe mbi "cilësinë dhe atraktivitetin e territorit".

U përgatitën përcaktimet e atraktivitetit dhe cilësisë së territorit, si dhe indikatorët, ku u morr parasysh kontributi nga politikbërësit dhe vendimmarrësit. Kujdes i veçantë iu kushtua pranisë, disponueshmërisë dhe cilësisë së të dhënave, dhe për këtë arsye aty ku nevojitej dhe ishte me rëndësi u përfshinë dhe u konsultuan vëzhguesit (zyrat statistikore dhe sondazhet gjeodezike). Treguesit u përcaktuan në bazë të të dhënave të mbledhura. Harmonizimi i propozuar i të dhënave dhe modeli i përbashkët i ndërveprimit u morr parasysh gjatë finalizimit të raportit. U hartuan raportet rajonale/nacionale të atraktivitetit për rajonet/vendet partnere si dhe raportet transnacionale të atraktivitetit të territorit. Këto raporte u diskutuan me politikbërësit në mënyrë që t'u përshtaten nevojave të tyre.

- **përgatitje e analizës së mangësive** në rajonet/vendet e ndryshme për të identifikuar mangësitë më të mëdha në vend/rajon dhe mbi këtë bazë u propozua një plan veprimi për zbatim të sistemit territorial të monitorimit – çfarë mund tanimë të zbatohet në afat relativisht të shkurtër (në kuadër të projektit), cilat janë veprimet afatmesme dhe afatgjate, duke pasur parasysh sërish veçoritë lokale dhe solucionet e pranueshme për vendimmarrësit?

- **hartimi i rekomandimeve për politika** së bashku me palët e interesuara duke përdorur informacionet nga raportet e atraktivitetit të territorit në nivel nacional, rajonal dhe transnacional

---

### **2.3. PARTNERITETI I PROJEKTIT**

Partneriteti ATTRACT-SEE është projektuar si një kombinim i organizatave të ndryshme të nevojshme për të arritur objektivat e projektit dhe për të siguruar vazhdimësinë e rezultateve të projektit:

- **organizata me njohuri teknike, të cilat**

Ndërmorën detyrën e vështirë të përgatitjes të kornizës të monitorimit të territorit, metodologjinë e grumbullimit të të dhënave dhe përcaktimin e treguesve, si dhe formimin e procesit të bashkëpunimit territorial;

- **Organet publike në fushat e zhvillimit hapësinor dhe territorial,** të cilat ishin përgjegjëse për krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të monitorimit territoriale, duke ndjekur dhe analizuar tendencat dhe perspektivat e zhvillimit në territoret, dhe duke bashkëpunuar në zhvillimin e politikave të ndryshme nacionale ose rajonale duke krijuar dhe lehtësuar procesin e koordinimit të politikave;

- **partnerë me rrjete të vendosura transnacionale të përcaktuara që kanë siguruar shpërndarjen efektive të rezultateve të projektit në Evropën Juglindore.**

Për shkak se vendosja e sistemeve territoriale të monitorimit dhe procesi për koordinimin e politikave kërkon angazhimin e organeve rajonale dhe /



ose kombëtare, partneriteti ka kërkuar përfaqësim të mirë në këtë projekt në nivel lokal. Në fund efektet e politikave shihen në nivel lokal dhe përfshirja e administratorëve lokal është thelbësore për zbatimin e politikave. Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të projektit, ishte e nevojshme që **partneriteti të përfshijë organizatat nga vendet pjesëmarrëse që kanë kapacitetin dhe aftësinë për të marrë përsipër rolin e krijimit të sistemeve të monitorimit në territoret e tyre dhe për të lehtësuar procesin e koordinimit të politikave.** Andaj partnerët e projektit ishin kryesisht autoritetet publike që merren me çështje të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit në nivel kombëtar dhe/ose rajonal.

U siguroa mbulim i gjerë gjeografik i vendeve të EJK-së. Integrimi në projektin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat po përballen me zhvillimin e dobët të infrastrukturës kombëtare të të dhënave hapësinore dhe një mungesë të konsiderueshme të informacionit territorial, ishte një nga nxitësit kryesorë për përgatitjen e këtij projekti dhe për projektimin e partneritetit. Praktika e mirë dhe kapacitetet ekzistuese dhe aftësitë e partnerëve pa marrë parasysh origjinën e tyre janë të kombinuara për të arritur në zgjidhjet më të mira të mundshme për të arritur objektivat e projektit.

Bashkëpunimi vertikal u siguroa me përfshirjen e partnerëve në nivele të ndryshme: ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale (përmes organizatave partnere). Integrimi horizontal është siguruar nga përfshirja e autoriteteve publike që merren me zhvillimin territorial dhe koordinimin e sektorëve të ndryshëm, dhe përmes ekspertizës specifike sektoriale të partnerëve të përfshirë. Koordinimi horizontal dhe vertikal u forcua më tej gjatë zbatimit me përfshirjen të palëve të interesuara dhe krijuesit e politikave nga fusha të ndryshme të politikave dhe niveleve territoriale në aktivitetet e projektit

---

## 3. ARRITJET DHE REZULTATET E PROJEKTIT

### 3.1. ZHVILLIMI I KORNIZËS SË MONITORIMIT TERRITORIAL

Monitorimi territorial është rishikimi periodik i propozimeve të planifikimit gjatë zbatimit të politikës së planifikimit hapësinor. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimit hapësinor duhet të jetë një mjet i rëndësishëm për hartuesit e politikave për t'u mundësuar atyre të vlerësojnë tendencat e fundit të zhvillimit, të identifikojnë problemet dhe të komunikojnë nevojat për veprim. **Indikatorët sasiorë janë përdorur për të matur dhe për të mundësuar vlerësimin e tendencave të zhvillimit hapësinor**, që të sigurohet realizimi apo riformulimi i objektivave të planifikimit hapësinor.

Kuadri i monitorimit territorial (KMT) është model i një sistemi të monitorimit territorial (TMS). Vendet e Evropës Juglindore kanë sisteme të ndryshme të monitorimit territoriale në faza të ndryshme të zhvillimit. Disa sisteme janë në nivelin e modelit apo kuadrit dhe disa prej tyre janë më të avancuar, gjë që është paraqitur në faqet në vijim.

---

#### 3.1.1. Korniza e monitorimit territorial

Elementet kryesore të një KMT janë:

- korniza ligjore;
- korniza institucionale;
- korniza teknologjike;
- korniza financiare.

**Korniza ligjor** mund të njihet në nivel kombëtar dhe rajonal. Ligjet kombëtare përkatëse të monitorimit të territorit janë:

- në Kroaci – Ligji mbi planifikimin urban dhe ndërtimin, nga viti 2007;

- në Hungari - Ligji për zhvillimin territorial dhe planifikimin hapësinor, nga viti 1996;

- Në Serbi - Ligji për planifikim dhe ndërtim, nga viti 2009;

- në Slloveni - ishte Ligji për planifikim hapësinor, 2002-2007.

- Në Maqedoni - Ligji për zbatimin e planit hapësinor i Republikës së Maqedonisë (2004); Ligji për planifikim hapësinor dhe planifikim urban (2005) dhe Ligji mbi infrastrukturën e të dhënave kombëtare hapësinor (2014).

Në nivel rajonal, ka ligje në Austri në nivel të shteteve federale, por jo të gjithë kanë ligje që rregullojnë monitorim territorial. Në Itali ekziston një ligj rajonal për planifikim nga viti 2000 për rajonin e Emilia Romagna, dhe në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës ka ligj mbi planifikimin hapësinor dhe shfrytëzimin e tokës nga 2006 dha ligjet kantonale të planifikimit urbanistik. Aktet nënligjore për monitorimin territorial kanë ekzistuar në Hungari nga viti 1997, në Kroaci nga viti 2012, dhe në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës nga viti 2010.

**Kuadri institucional** është i përbërë nga institucione të niveleve të ndryshme territoriale të cilat kanë për qëllim të bashkëpunojnë horizontalisht dhe vertikalisht: institucionet në nivel kombëtar (ministritë në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Slloveni), institucionet e specializuara për planifikim hapësinor (Orok në Austri, HZPR në Kroaci, Vati në Hungari, AAP në Maqedoni dhe Rapp në Serbi), dhe institucionet rajonale dhe departamentet e tyre (Austria, Emilia Romagna, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina).

Bashkëpunimi horizontal bëhet jo vetëm në nivel kombëtar dhe rajonal, por edhe në nivel lokal, dhe në zonat ndërkufitare. NALAS dhe anëtarët e saj mbështesin bashkëpunimin ndërmjet

bashkësive lokale. Bashkëpunimi vertikal ka të bëjë jo vetëm me bashkëpunimin në mes të niveleve të ndryshme në kornizat kombëtare, por edhe në nivel ndërkombëtar në bashkëpunim transnacional.

**Korniza teknologjike** varet nga softueri që është përdorur, i bazuar në një platformë GIS, si dhe në një bazë të dhënash relacionale, siç janë Oracle apo SQL Server. Janë përdorur Standardet e Konsorciumi të hapur gjeohapësinor. Direktiva INSPIRE ofron një kuadër të përbashkët teknologjik për vendet e Evropës Juglindore.

**Kuadri financiar** varet nga burimet në dispozicion të përcaktuara nga buxhetet kombëtare, rajonale apo lokale. Investimet e huaja mund të sigurohen nga organizatat, institucionet ose bankat ndërkombëtare (OKB, BB, FMN, BERZH, BEI, etj). Mbështetja nga Bashkimi Evropian mund të merret me anë të programeve dhe fondeve të ndryshme (ERDF, IPA, Fondi i kohezionit, Fondit social, etj). Investimet private mund të jenë të pavarur ose të realizohen në partneritet me investimet publike. Ka forma të tjera të investimeve në dispozicion, siç janë koncesionet, donacionet, kreditë etj.)

---

### **3.1.2. Sistemi i monitorimit territorial**

SMT është drejtpërdrejt i lidhur me dokumentet e planifikimit hapësinor, raportet e zhvillimit hapësinor dhe të sistemit të informacionit për zhvillimin hapësinor. Elementet e saj kryesore janë:

- objektivat e planifikimit hapësinor;
- propozime dhe prioritete për planifikimin hapësinor;
- treguesit e monitorimit territorial;
- modeli i sistemit të informacionit të zhvillimit hapësinor.

Dokumentet e **planifikimit hapësinor** në vendet partnere përmbajnë objektivat e planifikimit dhe propozimet e planifikimit hapësinor. Këto lloje të planeve hapësinore janë identifikuar në vendet partnere:

- Zhvillimi i konceptit, strategjisë ose planit të zhvillimor;
- Plani hapësinor i njësisë federale;
- Plani hapësinor ose zhvillimor rajonal;
- Plani i koordinimit krahinor;
- Plani me qëllim të veçantë ose plani i veçantë hapësinor;
- Plani lokal hapësinor ose zhvillimor;
- Plani i detajuar komunal urbanistik, i zonimit ose përdorimit të tokës.

Gjatë projektit është zgjedhur një grup i përbashkët i treguesve për atraktivitetin. Vlerat e treguesve janë grumbulluar për të përgatitur Raportet Kombëtare të Atraktivitetit Territorial. Raportet territoriale të atraktivitetit kanë katër pjesë kryesore: hyrje, tregues, atraktiviteti në politikat ekzistuese të zhvillimit, dhe prioritetet e atraktivitetit territorial të përqendruara në popullsinë, turistët, investimet dhe njohurive dhe inovacionit. Raportet nacionale të atraktivitetit territorial përfshihen në raportin transnacional të atraktivitetit. Qëllimi i Raportit transnacional të atraktivitetit territorial është të japë një panoramë të përgjithshme mbi temën e atraktivitetit në gjithë Evropën Jug-Lindore, duke mbështetur hartuesit e politikave mbi atraktivitetin territorial, duke siguruar integrim dhe analizë ndërsektoriale të rezultateve të projektit.

**Praktika e mirë** nga të gjitha vendet partnere është paraqitur shkurtimisht në Raportin mbi sistemet e monitorimit territorial. Janë mbledhur llojet e ndryshme të praktikave monitoruese: kombëtare, rajonale, sektoriale dhe ndër-kufitare. Këto shembuj të praktikave të mira japin një pasqyrë të gjendjes së monitorimit territorial në vendet partnere. Korniza propozuar e përbashkët territoriale për sistemin e monitorimit të atraktivitetit territorial bazohet edhe në përvojën e mëparshme të partnerëve dhe në rezultatet e projektit Attract-SEE.

---

### **3.2. FORMËSIMI I PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL**

Në mënyrë që të zgjidhen problemet të identifikuar në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të zhvillimit hapësinor, partnerët e projektit Attract-SEE kanë identifikuar dhe zhvilluar elementet e një kornize rajonale të monitorimit të territorit që nevojiten për zhvillimin e koordinuar të atraktivitetit territoriale në Evropën Juglindore në të ardhmen.

**Korniza rajonale e monitorimit territorial përfshin tetë elemente që ofrojnë bazë të mjaftueshme dhe relevante për ndërtimin e një sistemi të shpërndarë informacioni për monitorimin territorial në rajonin e Evropës Juglindore.** Pas themelimit, ky sistem i përbashkët i monitorimit territorial duhet të paraqes një burim dhe platformë të besueshëm të informacionit për një vendimmarrje të bazuar në dëshmi, në kohë dhe të koordinuar dhe për përkthimin e politikave të BE-së në nivel trans-nacional dhe nacional, pra rajonal.

Për më tepër, korniza e propozuar rajonale për monitorimin territorial Attract - SEE jep detajet e nevojshme për zhvillimin e sistemeve të ndërveprueshme të monitorimit territoriale në nivel të secilit partner, dhe gjithashtu lë hapësirë të mjaftueshme për të akomoduar specifikat dhe nevojat e veçanta të secilit vend apo rajon. Krahas monitorimit të atraktivitetit territoriale, korniza rajonale e Attract-SEE dhe sistemi i informacionit rajonal mund të përshtatet dhe të zbatohet në dimensionet dhe karakteristikat e tjera të zhvillimit territorial.

Me qëllim të zbatimit të rezultateve dhe udhëzimeve të zhvilluara gjatë projektit Attract-SEE, dhe të ndërgjegjesimit për avantazhet e zhvillimit dhe menaxhimit territorial në rajonin e Evropës Juglindore, secili partner i projekti ka hartuar një plan veprimi. Planet e veprimit përfshijnë një listë të veprimeve dhe zgjidhjeve që duhet të plotësohen nga secili partner në fushat e kornizave ligjore, teknologjike, financiare dhe organizative me qëllim të integritit të elementeve të përbashkëta të kornizës të monitorimit territorial në kornizat nacionale dhe/ose rajonale. Pas zbatimit të planeve të veprimit, të gjithë partnerët e Attract-SEE në të

ardhmen duhet të jenë në gjendje për të komunikuar dhe koordinuar në mënyrë efikase dhe efektive planifikimin territorial dhe idetë zhvillimore, iniciativat dhe aktivitetet, dhe në këtë mënyrë të ndërtojnë veprimet e zhvillimit dhe sinergjinë midis palëve drejt arritjes së vizionit të Strategjisë Evropa 2020.

Figura 1: Korniza rajonale e monitorimit territorial ofron platformë dhe udhëzime për ndërtimin apo përmirësimin e kornizës nacionale / rajonale të monitorimit territorial në katër fusha: ligjore, teknologjike, financiare dhe organizative)

---

### **3.3. ATRAKTIVITETI TERRITORIAL**

#### **Koncepti i atraktivitetit territorial**

Qasja metodologjike për të arritur objektivin e një kornize të përbashkët të atraktivitetit të territorit përfshin tre hapa, të zhvilluara në mënyrë komplementare.

**Hapi 1 përfshin shqyrtimin e dokumenteve zyrtare** (planet dhe programet strategjike dhe / ose operative) të miratuara nga shtetet / rajonet e partnerëve, për të parë se çfarë kuptimi ka "atraktiviteti territorial" sipas karakteristikave të ndryshme.

Për këtë qëllim u zhvillua "një mjet kërkimi" për të adresuar këto çështje:

a) sistemet e monitorimit territorial në përdorim në shtetet / rajonet e partnerëve dhe identifikimin e shembujve të praktikave të mira specifike;

b) përcaktimi i atraktivitetit të territorit përmes tre pyetësorëve për vlerësim lidhur me konceptin, asetet, dhe (nëse ka) treguesit specifike që dolën nga studimi i të dhënave të disponueshme.

**Hapi 2 synon të vlerësojë përgjigjet e ofruara nga partnerët me një vështrim të parë në konceptin e atraktivitetit të Territorit (AT) në përdorim brenda çdo konteksti dhe pasojat e tij** (p.sh. atraktivitet ndaj kujt, ku, si, etj) dhe një klasifikim paraprak i pasurisë kapitale territoriale të

merren parasysh. Analiza e dokumenteve zyrtare të programit nxori në pah një mungesë të përgjithshme të politikave specifike të fokusuara në atraktivitetin në zonën e Evropës Juglindore. Partnerët e Attract-SEE nuk kanë tendencë për të identifikuar pasuritë të cilat nevojitet të "klasifikohen" dhe të radhiten sipas një perspektive të përbashkët. Këto elemente konsiderohen si kusht themelor për krijimin e një kornize të përbashkët për konceptin e atraktivitetit.

**Në Hapin 3 nga palët dhe partnerët ndërkombëtarë u kërkua që të shprehin mendimin e tyre për rëndësinë e aseteve territoriale të identifikuar** për Vlerësimin e atraktivitetit të territorit, për të marrë një pasqyrë të përditësuar të konceptit AT dhe të aseteve që do merren parasysh, të përshtatura ndaj perspektivave dhe nevojave të secilit partner.

### **Përdorshmëria e rezultateve**

Supozimi kryesor i projektit është se ndryshimet në format e kapitalit territorial dhe mënyrat në të cilat ato janë mobilizuara në vendet përkatëse (rajonet dhe qytetet në këtë rast) sjellin ndryshime në "pozicionimin" relativ të rajoneve në lidhje me atraktivitetin dhe potencialet zhvillimore të tyre. Duke pasur parasysh këtë, hartuesit e politikave duhet të kuptojnë se çfarë përbën atraktivitetin e qyteteve dhe regjioneve evropiane dhe implikimet për zhvillimin e politikave të dizajnuara për të rritur ndikimin e Direktivave Evropiane Hapësinore, në nivele të ndryshme (nga lokale në nivel të BE-së), si dhe rëndësinë e politikave sektoriale (jo-hapësinore) dhe implikimet e politikave më gjithëpërfshirëse si Evropa 2020.

Ne kemi argumentuar se:

- marrëdhëniet komplekse (bashkëveprimet) mes formave të ndryshme të kapitaleve territorial shpjegojnë aftësinë diferenciale të vendeve për të tërhequr dhe mbajtur audienca të ndryshme të synuara;



- megjithatë, ne gjithashtu kemi argumentuar se prania e madhe e kapitaleve territoriale nuk nënkupton automatikisht atraktivitetin dhe mbajtjen e tyre;

- rëndësi shumë të madhe ka kapaciteti i pushtetit lokal për të mobilizuar asetet, nga aspekti i përdoruesve dhe investitorëve ekzistues dhe potencial.

---

### **3.4. ZHVILLIMI I TREGUESVE TË PRANUAR**

#### **Verifikimi i disponueshmërisë së karakteristikave të të dhënave të futura**

Procesi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për të krijuar tregues të atraktivitetit territoriale filloi pas përzgjedhjes të përbashkët të këtyre treguesve. Hapi i parë ishte kërkimi i të dhënave në dispozicion dhe mbledhja e metadatave të detajuara. U përgatit një pasqyrë e të dhënave për secilin vendin / rajon për të mbledhur informacionin e nevojshëm për përgatitjen e një metodologjie të qëndrueshme të përbashkët për përcaktimin e treguesve për të gjithë partnerët e projektit. Çdo pasqyrë përbëhet nga grupe të informatave themelore mbi grupet e të dhënave në dispozicion. Një dokument model i përbashkët u përdor për të përgatitur raporte të qëndrueshme për çdo vend / rajon. Të dhënat janë grupuar sipas aspekteve të mbuluara (ekonomisë, shoqërisë, mjedisit, trashëgimisë, etj). Informacion bazë për çdo grup të dhënash përbëhet nga:

- grupi i të dhënave dhe përkthimi (emri zyrtar i regjistrimit, emir i përbashkët i grupit të të dhënave, ose fjalët kyçe);
- burimi i grupit të të dhënave (institucioni, pronari i të dhënave ose ofruesi i të dhënave, status i institucionit);
- rregulloret përkatëse (ligje, akte, tjetër legjislacion);
- standardet e përdorura (standardet ndërkombëtare dhe kombëtare, udhëzimet, kodet, etj);

- disponueshmëria dhe qasja ndaj informacionit (personale, afariste, kufizimet e të dhënave ushtarake, falas, të pagueshme +llojin e taksave, të shkarkueshme, të dorzueshme + lloji e mjetit të ruajtjes);
- Mbulimi hapësinor dhe periudha e mirëmbajtjes (vendi, toka/regjioni, krahina/rrethi, komuna, vetëm rajonet e përzgjedhura);
- Përmbajtja (shtresa të të dhënave, temat e të dhënave, tabelat e të dhënave, karakteristikat e të dhënave, veçori të rëndësishme);
- Cilësia e informacionit - niveli i detajeve, saktësia (rezoluta e të dhënave, shkalla e hartëzimit, njësia e kapjes së të dhënave hapësinore ose saktësia pozicionale për të dhënat të gjeolokalizuar me koordinata);
- shënime/vërejtje;
- Tregues për të cilat të dhënat mund të jenë të dobishme. Pjesa e fundit është përdorur për të përcaktuar lidhje me treguesit e mundshëm që mund të llogaritet duke përdorur të dhënat.

### **Metodologjia për përcaktimin e treguesve të atraktivitetit territorial**

Metodologjia e zakonshme për llogaritjen e treguesve të atraktivitetit territoriale pasqyron disponueshmërinë, afatet kohore, dhe rezolucionin hapësinor (niveli i detajeve) të të dhënave të përshkruara në përmbledhjen e të dhënave. **Për përcaktimin e treguesve të përbashkët të atraktivitetit, u zgjodh njësia NUTS 3 ose ekuivalentët.** Aty ku të dhënat mungonin në këtë nivel, treguesi u përpunua në nivel kombëtar apo - në disa raste - për njësi të tjera hapësinore / vende (p.sh. rajon, qytete). **Një periudhë vjetore u zgjodh për përcaktimin e vlerave treguese dhe 2013 u zgjodh si viti referues.** Për "raportet zero", të dhënat janë mbledhur gjatë të paktën një periudhe pesë-vjeçare (2008-2012), nëse ka qenë e mundur. U përpunua një tendencë kohore për secilin tregues për të vlerësuar prirjet lineare duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël. **U përcaktua një trend vjetor i treguesit si një përqindje e rritjes / rënies së vlerës të treguesin në vit.** Raportet përfshijnë për secilin tregues:

- titujt e burimit të grupeve të të dhënave dhe organizata(t) përgjegjëse;

- lokator i burimit të grupeve të të dhënave – ueb link i drejtpërdrejt për qasje në të dhënat;
- informacion për grup të dhënash hapësinore dhe territoriale;
- konfigurimet e shkarkimit të grupeve të të dhënave (nëse ka);
- përcaktim i treguesit dhe njësi e treguesit (p.sh. pa njësi, %,  $\mu\text{g}/\text{m}^3$ , l/cap);
- përshkrimi i kalkulimit të treguesit dhe hapat e përpunimit të të dhënave;
- përshkrimi i vlerësimit të tendencave të treguesit;
- vlerat karakteristike të treguesit (p.sh. min, maks);
- karakteristikat e tendencave vjetore të treguesit;
- diagramet dhe/ose hartat që tregojnë dallimet e treguesve mes regjioneve dhe ndryshimet me kohë (krahasime hapësinore dhe kohore);
- Vërejtje e përgjithshme për treguesit (interpretime themelore).

Një model i përbashkët është përdorur për të përgatitur grupe të qëndrueshme të treguesve të atraktivitetit territoriale për çdo vend/rajon.

### **Prezantimi dhe interpretimi i treguesve të atraktivitetit territorial**

Për secilin tregues të atraktivitetit territorial u shqyrtua një grup metadata dhe u dokumentua në përputhje me rregullat INSPIRE për metadata. Shumica e treguesve janë të bazuara në më shumë se një grup të dhënash, zakonisht me origjinë nga më shumë se një ofrues të dhënave. Procedura e plotë e llogaritjes është e qartë nga raportet e llogaritjes së treguesve, të cilat përfshijnë formulat dhe grafikët / listat e krijuara nga vlerat e treguesve që rezultojnë dhe tendencat vjetore të vlerave të treguesve. Listat më të zakonshme që përshkruajnë treguesit ishin:

- diagram bar me vlera të treguesve për periudhën më të fundit ose periudhën referuese (parashikim);
- diagram me linjë me ndryshimet e treguesve për periudhat e konsideruara (që tregojnë tendencën);
- diagram torte për analizë të detajuar të treguesit (p.sh. me kategori të ndikimit);
- diagram bar me tendenca vjetore të treguesit (në %) për periudhat e shqyrtuara.

Si rezultate të projektit, secili partner i projektit ka përgatitur Raport (nacional) të atraktivitetit të territorit duke përdorur këtë metodologji të përbashkët (tetë raporte). Në bazë të këtyre raporteve, një raport sintezë u përgatit për Evropën Juglindore – Raporti (Trans-nacional) për atraktivitetin e territorit. Këto raporte konsiderohen si "raporte zero" për sistemet e ardhshme kompatible të monitorimit që mbulojnë rajonin. Për raportet e atraktivitetit territorial, janë përdorur prezantime hartografike përveç grafikëve të përmendura më lart. Si një shembull i paraqitjes së një treguesi të raportit nacional të atraktivitetit, konsumi i ujit për kokë banori në Slloveni është e treguar sipas rajoneve në figurat 2 deri në 4.

*Figura 2. Konsumi ditor i ujit për kokë banori në Slloveni sipas rajonit në vitin 2013..*

*Figura 3. Konsumi ditor i ujit për kokë banori në Slloveni sipas rajonit në vitin 2008–2012.*

*Figure 4. Tendencat vjetore të konsumit ditor të ujit për kokë banori në Slloveni sipas rajonit në vitet 2008–2012.*

Vërejtjet përkatëse të përgjithshme (interpretimi i treguesit bazë) do të duken si në vijim:

"Konsumi mesatar ditor i ujit në Slloveni ishte rreth 113 l / për kokë në vitin 2012. Megjithatë, ky tregues ndryshonte ndjeshëm ndërmjet rajoneve statistikore. Konsumi minimal i ujit është vërejtur në rajonin e statistikor Koroška (~ 53 l / për kokë), ndërsa maksimali është vërejtur në rajonin statistikor Gorenjska (~ 140 l / për kokë). Tendenca e përgjithshme e konsumit të ujit në Slloveni mund të përshkruhet si ulje e vogël - trendi vjetor ka qenë -1,49%. Megjithatë, në pesë rajonet konsumi i ujit ka qenë ende në rritje. Rajoni më i keq statistikor në këtë drejtim ka qenë rajoni Notranjska me një tendencë vjetore prej 4,90%. Rajoni më i favorshëm ka qenë Rajoni Statistikor Koroška me një tendencë vjetore prej -6,12%. "

## **Grupi i përbashkët i propozuar i treguesve të aseteve**

Bazat ekzistuese e të dhënave u përdorën për të gjetur tregues përkatës për asetet individuale. Këto baza të dhënash ishin nga Eurostat, OECD, Komisioni Evropian, Agjencia Evropiane e Mjedisit, Kombet e Bashkuara, UNESCO, Banka Botërore, dhe projektet e ESPON-it.

Zgjedhja e treguesit gjithashtu varej nga lloji i treguesit. Ishte e rëndësishme që për çdo aset të identifikohen së paku dy nga treguesit kryesorë, "gjendja" (tregues që kanë për qëllim të sigurojnë një përshkrim të thjeshtë të gjendjes aktuale të zhvillimit) dhe "presioni" (këta tregues janë përdorur për të diagnostikuar dhe vlerësuar procesin që do të ndikojë në gjendjen e progresit). Disa nga treguesit e zgjedhur ishin "objektiv, përgjigje të treguesve të performancës" (këto vlerësojnë ndikimin nga ndryshimet e politikave).

Lista e parë e treguesve përmbante 41 indikatorë në nivel trans-nacional. Përzgjedhja përfundimtare është bërë pas një analize të të dhënave në dispozicion.

## **Analiza e disponueshmërisë të grupit të të dhënave**

Duhej të verifikohen qëllimet kryesore të analizës për disponueshmërinë e të dhënave (për çdo vend / rajon):

- Disponueshmëria e grupeve të të dhënave për grupet e propozuara të treguesve;
- Frekuencat e mirëmbajtjes të grupeve të të dhënave;
- nivelet të shkallës në dispozicion të grupeve të të dhënave.

Kishte dy hapa në analizën e disponueshmërisë të grupeve të të dhënave:

- vlerësimi i disponueshmërisë të raportuar të grupeve të të dhënave;

- vlerësimi përfundimtar i disponueshmërisë të grupeve të të dhënave.

Për hapin e parë u përdorën vetëm Raportet përmbledhëse të metadatave të hartuara nga partnerët e projektit për vendet/rajonet e tyre.

Për vlerësimin përfundimtar, informacioni mbi disponueshmërinë e grupeve të të dhënave është zgjeruar duke përdorur ofruesit ndërkombëtarë të të dhënave të listuar në seksionin paraparak.

Rezultatet e vlerësimit përfundimtar të disponueshmërisë të grupeve të të dhënave tregojnë se:

- 6 tregues (nga 41) u llogaritën nga më pak se 50 % të partnerëve të projektit;
- 5 tregues u llogaritën nga 50 % të partnerëve të projektit;
- 30 tregues u llogaritën nga më shumë se 50% të partnerëve të projektit.

### **Analiza e frekuencave të mirëmbajtjes për grupet e disponueshme të të dhënave**

Qëllimi i analizës së periudhës së mirëmbajtjes për grupet e disponueshme të të dhënave ishte të përcaktojë "frekuencat e mirëmbajtjes të pranueshme për të gjithë " (të llogaritjes) për treguesin e veçantë nga grupi i përbashkët i treguesve në shkallë të ETL-së.

Periudhat e raportuara të mirëmbajtjes janë organizuar (logjikisht) sipas periudhës (nga më e shkurtra te më e gjata). Frekuencat mesatare të mirëmbajtjes ishin:

- **çdo ditë** për 2 tregues;
- **çdo vit** për 33 tregues;
- **çdo disa vjet** për 3 tregues;
- **Nuk dihet (ND)** për 3 tregues.

### **Analiza e nivelit shkallë për grupet e disponueshme të të dhënave**

Qëllimi i analizës së nivelit shkallë për grupet e disponueshme të të dhënave ishte që të përcaktohen "njësi hapësinore të pranueshme (për llogaritje) për një tregues të veçantë nga grupi i përbashkët i treguesve në nivel të EJK-së".

Niveli në shkallë u raportua nga partnerët e projektit (vendi, rajoni, federata, shteti federal, makro-rajon, krahinë, rajon statistikor, qarkut, NUTS<sub>2</sub>, NUTS<sub>3</sub>, qytetit, komuna, lagje ose e panjohur).

Problemi këtu është se nivelet shkallë ishin të vështira për të krahasuar. Sistemi NUTS ende nuk është përcaktuar për Serbinë, dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Për dy të fundit, disa studime janë në dispozicion, kështu që një krahasim mund të bëhet, por ky sistem nuk përdoret për përpunim statistikor.

Nivelet shkallë të raportuara janë të organizuar (logjikisht) sipas zonës së mbuluar (nga më e vogla deri te më e gjata). Nivelet shkallë mesatare ishin:

- Të gjitha nivelet e shkallës për 1 tregues;
- Vendi / rajoni ose NUTS<sub>2</sub> ose NUTS<sub>3</sub> për 2 tregues
- Vendi / rajoni ose NUTS<sub>2</sub> për 9 tregues;
- Vendi / rajoni për 29 tregues

### **Lista përfundimtare e grupit të përbashkët të treguesve në nivel transnacional**

Baza për zgjedhjen përfundimtare të treguesve në nivel transnacional ishte një analizë e përmbledhjeve të metadatave. Përzgjedhja përbëhej nga treguesit për të cilat shumica e partnerëve në projekt kishin të dhëna në dispozicion. Treguesit e eliminuar mund të vendosen në 'listë dëshirash' në nivel kombëtar ose në listë dëshirash të partnerit të projektit për çdo vend / rajon.

Numërimi i fundit i treguesve ka qenë 31 për partnerët e ERDF dhe 29 për partnerët e IPA-s. Lista përfundimtare e grupit të përbashkët të treguesve

në nivel transnacional është dhënë në tabelën e mëposhtme. Dy treguesit që ishin në dispozicion vetëm për partnerët ERDF janë paraqitur në gri.

*Tabela 1 Lista përfundimtare e grupit të përbashkët të treguesve në nivel transnacional*

### Kapitali mjedisor

Cilësia mjedisore		Lloji
1.	Emisioni i gazrave sere (tregues Evropa 2020)	Gjendje
2.	Ndotja e ajrit: PM <sub>10</sub>	Gjendja
3.	Ndotja e ajrit: Përqendrimi i ozonit	Gjendja
4.	Popullsia lidhur me trajtimin e ujërave të zeza urbane me të paktën trajtim sekondar	Përgjigje

Integriteti territorial/i ekosistemit		Lloji
5.	Sipërfaqe artificiale nga Corine Land Cover	Presion

Burime dhe energji natyrore		Lloji
6.	Energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme	Përgjigje
7.	Konsumi i ujit për kokë banori	Presion

### Kapitali antropik

Cilësi urbane		Lloji
8.	Popullsia urbane/rurale (ose klasifikimi urban rural)	Gjendja



<b>Cilësia e peizazhit</b>		<b>Lloji</b>
9.	% nga zona tokësore e mbrojtur (total dhe sipas rajonit ekologjik)	Gjendja

<b>Infrastrukturat</b>		<b>Lloji</b>
10.	Popullsia (ose amvisëritë) me qasje në internet me shpejtësi të lartë broadband (1 Mbit / sekonda shkarkim dhe ngarkim)	Gjendja

### Kapitali socio-kulturor

<b>Kultura</b>		<b>Lloji</b>
11.	Numri i teatrove, muzeve, galerive dhe bibliotekave publike për 10,000 banorë	Gjendje
12.	Vendet kulturore evropiane në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s 2010	Gjendje

<b>Cilësia e jetës</b>		<b>Lloji</b>
13.	Jetëgjatësia sipas gjinisë (Treguesi Evropa 2020)	Gjendje
14.	Të ardhurat bruto familjare të disponueshme	Gjendje
15.	Njerëzit në rrezik të varfërisë apo të përjashtimit social (Treguesi Evropa 2020) ose % në rrezik nga varfëria	Presion

### Kapital ekonomik/njerëzor

<b>Njohuri dhe inovacion</b>		<b>Lloji</b>
16.	Popullsia e moshës 25-64 me arsim të lartë	Gjendje
17.	Numri i të punësuarve në Hulumtim dhe zhvillim nga fuqia e përgjithshme e punës	Gjendje
18.	Shpenzime për Hulumtim dhe zhvillim eksperimental si % e PBB-së (Tregues Evropa 2020)	Përgjigje
19.	Aplikimet për patentim të dorëzuara tek Zyra e Patentave Evropiane për 1 milion popullsi	Gjendje

1

<b>Punësim</b>		<b>Lloji</b>
20.	Shkalla e punësimit 20-64 vjeç sipas gjinisë [%] (rajonal) (Tregues Evropa 2020)	Gjendja
21.	Shkalla e papunësisë së të rinjve	Presioni

<b>Specializime / Sektorët kryesorë</b>		<b>Lloji</b>
22.	Pjesa e punësimit sipas sektorëve	Gjendja

<b>Turizëm</b>		<b>Lloji</b>
23.	Numri i qëndrimeve me fjetje të turistëve për kokë banori në vit	Presioni
24.	Pjesa e punësimit në turizëm në punësimin total	Gjendja

<b>Promovimi i investimit</b>		<b>Lloji</b>
-------------------------------	--	--------------

25.	Lejet e ndërtimit (komerciale, industriale, institucionale, rezidenciale) [në €]	Gjendja
26.	% e PBB-së e investimeve të huaja të drejtpërdrejta	Përgjigja

<b>Popullsia</b>		<b>Lloji</b>
27.	Shkalla e rritjes së popullsisë	Gjendja
28.	% e popullatës në varg moshe 20-64 vjet	Presioni
29.	Indeksi i plakjes	Presioni

### Kapitali institucional

<b>Qeverisja</b>		<b>Lloji</b>
30.	Përbërja e shpenzimeve të pushtetit lokal	Gjendja

<b>Marrëdhëniet ndërkombëtare</b>		<b>Lloji</b>
31.	Numri i studentëve të huaj	Gjendja

---

### 3-5. KOORIDNIMI I POLITIKËS

Zyra për Planifikim Kombëtar Ekonomik (ONEP) nga Hungaria ka ofruar **një metodologji dhe mjete për koordinimin e politikave** të monitorimit të territorit që shërben në përmirësimin e atraktivitetit territorial. ONEP ka përmbledhur gjetjet e tij në një manual. Ky veprim ka mbështetur partnerët e tjerë të projektit dhe ecurinë e pakove të tjera të punës. Manuali është përgatitur në kuadrin e një procesi të orientuar kah praktika: **aktivitetet e projektit kanë ndihmuar për të testuar idetë tona fillestare të koordinimit të politikës kryesore** në një kontekst të vërtetë politik dhe pune në vende të ndryshme.

Manuali paraqet një qasje dhe metodologji të përgjithshme për koordinimin e politikave, duke u fokusuar kryesisht në palët e interesuara dhe aktorët në administratën publike. Manuali paraqet të gjitha aspektet përkatëse të një procesi të planifikuar si duhet për koordinimin e politikave: (1) parimet dhe udhëzimet për zbatimin, (2) përfitimet e pritura, (3) nxitësit dhe barrierat e mundshme të përfshirjes së palëve të interesuara, (4) mjetet dhe metodat për ndërtimin e kapaciteteve, (5) teknika që përdoren gjerësisht në të gjithë Evropën dhe në botë. Përveç kësaj qasjeje të përgjithshme, Manuali i kushton vëmendje të veçantë çështjes së koordinimit të politikave me monitorimin e territorit.

Në mënyrë që Manuali të jetë relevant në praktikën e përditshme të planifikuesve dhe profesionistëve të tjerë vendimmarrës, mendimet e partnerëve janë mbledhur me anë të pyetësorëve. Punëtoritë nacionale për përfshirjen e palëve të interesuara u organizuan gjithashtu për të identifikuar idetë më interesante dhe të realizueshme. Partnerët e projektit siguruan shembuj për Manualin që dolën gjatë aktiviteteve të projektit dhe që kanë të bëjnë me përmbajtjen ose aspektet formale të koordinimit të politikave. Manuali paraqet këto ide në mesin e çështjeve të veçanta mbi atraktivitetin dhe zhvillimin territorial. Manuali gjithashtu ofron udhëzime praktike mbi organizimin dhe menaxhimin e përfshirjes së palëve të interesuara.

Struktura e Manualit është projektuar për të ofruar një zbatueshmëri të gjerë. Me shpresë se kjo do të tërheqë vëmendjen e lexuesve me një ekuilibër të mirë në mes të tekstit shpjegues dhe elementeve informuese grafike. Manuali ka një strukturë të përqendruar rreth zgjidhjes, dhe

përmbajtja e tij udhëzon përdoruesit lehtë në mesin e mesazheve dhe çështjet të ndryshme të koordinimit.

---

### **3.5.1. Manuali për procesin e koordinimit të politikave**

Problemet dhe sfidat me të cilat përballen shoqëritë moderne janë komplekse, dhe zgjidhjet nuk mund të krijohen vetëm nga një grup i ngushtë i ekspertëve brenda një sektori specifik. **Gjetja e zgjidhjeve për problemet ekzistuese që i plotësojnë nevojat reale shoqërore** kërkon bashkëpunimin dhe koordinimin në nivele të ndryshme, duke filluar nga faza e krijimit të politikave, programeve dhe projekteve, dhe vazhdon gjatë gjithë zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të tyre. Ndërgjegjësimi për rëndësinë e koordinimit të politikave tashmë ekziston, por zbatimi i tij në praktikë është ende i dobët në vendet e projektit. Ne jemi ballafaquar me mungesën e një kornize për kushtet për koordinimin, udhëzimet metodologjike, njohuritë, aftësitë dhe praktikat e mira. Projekti Attracct - SEE ka bërë një hap përpara në drejtim të tejkalimit të kësaj mangësie.

Sfida e koordinimit të politikave është diskutuar nga këndvështrime të ndryshme në shumicën e punëtorive të palëve të interesuara në vendet e projektit. Përvojat e fituara së bashku me rekomandimet për koordinim më efikas të politikave janë paraqitur në Manualin e Procesit të Koordinimit të Politikave. Ky seksion përmbledh pikat kryesore të Manualit.

#### **Si e kuptojmë koordinimin e politikave?**

Me definicion koordinimi i politikave është një sërë aktiviteteve që u mundëson organizatave të ndryshme përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike që të bashkëpunojnë në mënyrë që të shmanget mospërputhja e qëllimeve dhe masave, dhe defektet në ofrimin e shërbimeve publike. Koordinimi i politikave ndodh kur agjencitë sektoriale të zhvillimit të politikave, autoritetet qeveritare, organizatat joqeveritare dhe aktorët e tjerë relevant bashkohen për të hartuar dhe zbatuar politika të përbashkëta. Të gjithë aktorët përpiqen drejt një qëllimi të përbashkët, politikë e cilësisë së lartë dhe e realizueshme që përfiton nga sinergjia e grupit. Koordinimi i politikave nuk është një proces i centralizuar me rezultate të paracaktuara. Është

më tepër një **menaxhim i ndërvarësisë ndërmjet aktiviteteve që çojnë drejt një vizioni të përbashkët dhe qëllimeve të përbashkëta**. Rezultatet janë arritur përmes një procesi pjesëmarrës ndërveprues me shumë aktorë, përmes shkëmbimit të njohurive dhe përvojës, reflektimit, negocimit, përshtatjes dhe të mësuarit kolektiv.

### **Pse koordinimi i politikave është i rëndësishëm dhe i dobishëm?**

Koordinimi i politikës sjell efekte afatgjate të harmonizuara dhe cilësore për politikën. Aktorët e ndryshëm të përfshirë kontribuojnë me njohuritë dhe përvojën e tyre, me çka i afrojnë politikën më tepër drejt nevojave reale, prioriteteve dhe vlerave të bashkësive. **Ai forcon një kuptim të përbashkët të vizionit të politikës, objektivave dhe masave, dhe për këtë arsye mundëson zbatimin e duhur dhe përdorimin më efektiv të burimeve njerëzore, financiare dhe të tjera.**

Një proces efikas i koordinimit të politikave lidh dhe angazhon aktorë të ndryshëm dhe krijon besimin mes tyre, dhe ngrë nivelin e përbashkët dhe individual të dijes. Përfshirja e aktorëve të cilët më vonë do të zbatojnë masa të veçanta të politikave kontribuon në realizimin e plotë të politikës. E fundit por jo me më pak rëndësi, procesi krijon një ndjenjë të angazhimit dhe pronësisë së politikës, dhe rrit pranueshmërinë e saj, dhe aktorët mbështesin zbatimin e politikës në praktikë.

Kur flasim për politikën hapësinore, koordinimi i mirë mes politikave të ndryshme zhvillimore dhe sektoriale është një parakusht për arritjen e kohezionit territorial dhe objektivave të zhvillimit territorial në nivel trans-nacional, kombëtar, rajonal dhe lokal.

### **Cilat janë palët e interesuara në procesin e koordinimit të politikës?**

Në rastin e politikës hapësinore, **koordinimi i politikave duhet të përfshijë koordinimin vertikal** ndërmjet niveleve të ndryshme të hartimit të politikave, **koordinimin horizontal** midis zonave të ndryshme të politikave, **koordinimin territorial** mes zonave të ndryshme administrative ose llojeve të territoreve, dhe **koordinimin me palët e interesuara**, duke përfshirë publikun përkatës, biznesin, hulumtimin, dhe shoqërinë civile.

Palët e interesuara më poshtë janë të rëndësishëm për procesin e koordinimit të politikave:

- Përfaqësuesit e organizatave dhe agjencive përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave që përgatiten;

- Përfaqësues të sektorëve tjerë relevant që kanë ndikim në ose potencialisht mund të ndikohen nga politikat që përgatiten (në lidhje me problemet e identifikuar dhe arsyet e politikës, apo në lidhje me vizionin, objektivat, etj);

- Krijuesit dhe zbatuesit e politikave rajonale;

- Përfaqësuesit e administratës publike, vendimmarrësit në nivele të ndryshme dhe me përgjegjësi të ndryshme;

- Palët e interesuara relevante nga sektori publik dhe privat dhe shoqëria civile që janë të ndikuar nga politika, apo mund të kenë ndikim mbi politikën në përgatitje, ose kanë një interes të përfshihen në përgatitjen e politikave.

### **Cilët janë faktorët e suksesit të procesit të koordinimit të politikave?**

Faktorët e mëposhtëm ndikojnë në procesin e koordinimit të politikave:

- niveli i kulturës pjesëmarrëse në një shoqëri;

- vullneti dhe mbështetja politike;

- motivimi i palëve të interesuara;

- komunikim efikas dhe ofrim i informatave;

- burime të siguruara, veçanërisht udhëheqësi i projektit;

- njohuri dhe aftësi për dialog me shumë aktorë;

- forume të hapura për dialog;

- kornizë ligjore dhe baraspeshë e pushtetit;

- monitorim, vlerësim dhe të mësuarit të ndërsjellë.

### **Si mund të zbatohet koordinimi i politikave në praktikë?**

Tre hapat kryesorë janë vendimtarë për zbatimin e një procesi efektiv të koordinimit të politikave: një plan i mirë i procesit, informim efektiv i të gjitha palëve të interesuara, dhe ngritja e forumeve konsultative.

**Dialogu i grupeve të interesit duhet të fillojë herët** në përgatitjen e politikave, dhe duhet të vazhdojë në të gjitha fazat e procesit. Për këtë qëllim është e rekomandueshme që të themelohet një **organ për koordinimin e politikave** (me një koordinator kryesor dhe moderator të aftë) dhe të përgatitet një **dizajn për një proces** të koordinimit të politikave me përcaktimin e elementeve kyçe të mëposhtme:

- Qëllimet kryesore Koordinim të Politikave (reale dhe të kuptueshëm për të gjitha palët e përfshira);

- Objektivat dhe çështjet specifike që do të diskutohen në fazat e veçanta të përgatitjes të politikave;

- Parimet dhe rregullat për koordinim cilësor dhe funksional të politikave që duhet të respektohen nga të gjithë aktorët e përfshirë;

- material informuese, mjete dhe kanale komunikimi;

- konsultime / forume dialogu dhe ngjarje me agjendë;

- mënyra për të marrë parasysh rezultatet e konsultimeve;

- Krijimi i një rrjeti të palëve të interesuara të angazhuar për bashkëpunim të ardhshëm.

Dhënia e informacionit duhet të përmbajë të gjitha **informatat dhe të dhënat që kanë të bëjnë me përmbajtjen** si dhe informatat në lidhje me gjithë procesin e konsultimit dhe rezultatet dhe ndikimin e tij potencial. **Komunikimi me palët e interesuara** duhet të jetë i vazhdueshëm gjatë gjithë procesit.

Planifikimi i mirë i një procesi të koordinimit nuk nënkupton arritjen e qëllimit përfundimtar, por sigurisht që është një parakusht për zbatimin efektiv të koordinimit të politikave që ndjek në praktikë.

Atë që keni lexuar më lart janë vetëm përshkrime të shkurtra të aspekteve kryesore të procesit të koordinimit të politikave. Ju ftojmë që të mësoni më shumë nga Manuali për procesin e koordinimit të politikave të Attract-SEE.



---

## 4. VLERA E SHTUAR DHE KOMPONENTI INOVATIV I PROJEKTIT

Projekti Attract-SEE ka **paraqitur një qasje të re** për vendet partnere duke ndërtuar një kuadër monitorimi territorial që është i lidhur drejtpërdrejt me procesin e koordinimit të politikave dhe anasjelltas.

Projekti Attract-SEE është ndërtuar në supozimin se sigurimi i informacioneve të shëndosha territoriale në diskutimin **me palët e ndryshme do të përmirësojë procesin e koordinimit të politikave**. Ky supozim çoi drejt dizajnit të projektit me ndërthurjen e dy grupe aktiviteteve - ndërtimin e sistemit të monitorimit territorial për të përmirësuar njohuritë territoriale në njërin anë dhe në përfshirjen e palëve të interesuara në diskutimin rreth tendencave territoriale të zhvillimit dhe qëllimeve të politikës në anën tjetër.

Përvojat e fituara gjatë zbatimit të projektit dëshmuar supozimet.

Projekti Attract-SEE ka rritur kulturën pjesëmarrëse dhe bashkëpunimin sektorial me përfshirjen e aktorëve kyç në zbatimin e projektit, një traditë që nuk ka qenë e pranishme më herët në vendet e Evropës Juglindore. Në disa ngjarje të palëve të interesuara në të gjitha vendet e projektit, hartuesit e politikave dhe vendimmarrësit përgjegjës për zbatimin e politikave, si dhe përfaqësues të planifikimit hapësinor dhe organizatat rajonale të zhvillimit, përfaqësues të autoriteteve dhe agjencive lokale dhe kombëtare, studiues dhe përfaqësues të shoqërisë civile u bashkuan në një dialog rreth zhvillimit territorial dhe koordinimit të politikave. Dëshmitë e reja territoriale të prezantuara nga projekti nxitën përfshirjen e palëve të interesuara në një diskutim rreth gjendjes së territorit, problemeve dhe potencialeve të tij.

Pjesëmarrësit shprehën vlerën e shtuar të projektit dhe përdorshmërisë së informacionit territorial të prezantuar në punëtoritë e tyre aktivitetet e përditshme si dhe rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të sistemeve të monitorimit territorial nacionale / rajonale që japin informacion mbi nivelin lokal gjithashtu.

Qëllimi i angazhimit të këtyre palëve të interesuara në diskutime të përbashkëta nuk ishte vetëm për të sjellë njohuri të reja në procesin e zbatimit të projektit, por edhe për të kapërcyer hendekun në mes ekspertëve të cilët ofrojnë analiza territoriale dhe politikëbërësit dhe vendimmarrësit, të cilët përdorin këtë informacion në pjesën e tyre të ciklit politik. Ky proces inovativ pjesëmarrës ka kontribuar në arritjen e rezultateve më të mira të projektit dhe për zgjidhjen e problemeve të shpërndarjes dhe të komunikimit, si dhe për të kursyer kohë. Aktorët e përfshirë dhanë njohuritë dhe të dhënat e tyre, veçanërisht në lidhje me nevojat në punën e tyre profesionale në fushën e zhvillimit territorial. Ata gjithashtu komentuan edhe mbi rezultatet të ndërmjetme të projektit dhe dhanë propozime për të gjitha aspektet lidhur me përmbajtjen. Në këtë mënyrë, ata bashkë krijuan rezultatet përfundimtare të projektit dhe i bënë ato më të përdorshme. Në kuadër të projektit, informacionet u paraqitën para vendimmarrësve në një mënyrë të kuptueshme dhe interaktive, duke bërë të mundur diskutime dhe sqarime. Punëtoritë e palëve të interesuara kontribuan në përmirësimin e kuptimit të përbashkët të analizave të ekspertëve, dhe në përdorimin e një gjuhe të përbashkët. Vendimmarrësve iu dhanë prezantime të përshtatura për nevojat e tyre për të përmbushur kërkesat unike dhe të veçanta në politikën e zhvillimit territorial. Vendimmarrësit të cilët zakonisht kanë nevojë për informacion të shpejtë, mund t'i gjejnë ato tani edhe nëpërmjet internetit me tregues dhe të dhëna të sakta hapësinore mbi atraktivitetin për rajonet e partnerëve. Kjo mundëson që vendimet të jenë të bazuara në dëshmi të shëndosha dhe e bën zhvillimin territorial më efektive.

Tema kryesore në të shumtën e punëtorive për palët e interesuara ishte koordinimi politikave, dhe në bazë të këtij procesi ishte e mundur të bëhet një hap përpara në drejtim të përmirësimit të koordinimit të politikave në praktikë. Palët e interesuara në të gjitha vendet partnere kanë analizuar situatën aktuale dhe pengesat për koordinim më efikas të politikave, dhe kanë diskutuar mënyrat e forcimit të koordinimit të politikave në të ardhmen. Rekomandimet dhe udhëzimet metodologjike janë paraqitur në një nga produktet e projektit – Manuali për procesin e koordinimit të politikave.